



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 19932 Prot

Shkodër, më 20.12.2023

Lënda: Kërkese për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhe po ju dërgojme për shqyrtim dhe miratim projekt - vendimin "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025".

Duke ju uruar punë të mbarë !

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .202__

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .202__

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024”

Në mbështetje të neneve 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 të miratuar më datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 date “ Per financat e qeverisjes vendore” , ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar , ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar , udhezimit nr. 23 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te pergatitjes se programit Buxhetor Afatmesem të njesive të qeverisjes vendore” të ndryshuar, udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar këshilli bashkiak Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI



Zv. Kryetar

Rushi Bely

Zv. Kryetar

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Arben Bely

Drejtoria e te Ardhurave

Edrit Bely

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

^{PA} Pen: Rudina Kroja

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të
Territorit

Brunilda Kroja

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse

Andrita Hergjillo

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
trajtimit të AMTP

D/Alben Seka

Drejtoria e Turizmit

Jonida Kurti

Policia Bashkiake

Elton Dyliraj

Zv. Kryetar

Enis Byleci

Drejtoria e Financës

Blerta Mycobaj

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe
Personave me Aftësi Ndryshe

Solonez Dyliraj

Drejtoria e Shërbimeve Publike,
ndjekës se investimeve të Infrastruktura

Alfred Dulata

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Holmeta Kroja

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe
Menaxhimit të Ujërave

Fiola Vullaku

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,
Koordinimit të Investimeve

Alban Seka

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Behim Memaj

Drejtoria Juridike

Enxheta Dyliraj

Lidhja nr.1

**KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025**

Kalendari PBA & buxhetit vjetor

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë;
- Hyn në fuqi dhe shpërndahet te të gjitha njësitë shpenzuese nga kryetari i njësisë (Janar .2024).

Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2024);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2024).

Tavanet e shpenzimeve të PBA në nivel programi

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2024);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2024);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i taveve);
- Udhëzimi shpërndahet te njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i taveve / 20.03. viti 2024);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2024);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.viti 2024);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndan te të gjitha njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i taveve përfundimtare / 25.07. viti 2024).

Kërkesat sipas taveve

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda taveve përgatitore te Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill.viti t) dhe japin argumente për fonde / tavane shtesë;
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda taveve përfundimtare (1.08. viti 2024).

PBA & Buxheti vjetor

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t+1, t+2, t+3 (30.05.2024)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2024); •MFE-ja dërgon opinionion e saj mbi PBA-në te njësia vendore (20.06. viti 2024);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinion e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2024);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2024);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I (5.07 viti 2024);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2024);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2024);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2024);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar te MFE-ja 15.09.2024
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2024);
- MFE-ja dërgon opionin përfundimtar sipas rastit te njësia vendore (20.10.2024);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2024);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2024);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2024).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .202_

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”**

Bazuar në ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “*Per financat e qeverisjes vendore*”, në nenin 33, kreu VII, si dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23 date 30.07.2018 “*Per procedurat standarte te pergatitjes se programit Buxhetor Afatmesem te njesive te qeverisjes vendore*”, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor. Kalendarin miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor tek të gjitha njësitë shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Për hartimin dhe kërkesën për miratim të kalendarit të projekt programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025, jemi bazuar më saktësisht në ligjin Nr. 139/2015 të miratuar datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, në ligjin Nr. 9936 date 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, në ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 23 date 30.07.2018 “*Per procedurat standarte te pergatitjes se programit Buxhetor Afatmesem te njesive te qeverisjes vendore*” si dhe në Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “*Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*” te ndryshuar.

Kalendarin i propozuar për procesin e përgatitjes së projekt Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025, në Lidhjen I të Projekt-Vendimit “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”, bashkëngjitur këtij relacioni, përmban veprimet përkatëse që duhet të realizohen hap pas hapi, strukturat përgjegjëse dhe periudhat e afatet e përcaktuara.

Bazuar në referencat ligjore sipërcituar dhe shpjegimet përkatëse, kërkojmë nga ana juaj shqyrtimin dhe miratimin e projekt-vendimit “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt programit buxhetor afatmesem 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”.

Duke ju uruar punë të mbarë,


KRYETAR

Benet BECE


Zv. Kryetar

Konceptuan:

Zv. Kryetar



Zv. Kryetar



Drejtorja e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor



Drejtorja e te Ardhurave




Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Për: 

Drejtorja e Kontrollit dhe Zhvillimit të
Territorit


Drejtorja e Financës



Drejtorja Juridike



Drejtorja e Shërbimeve Publike, ndjekjes së
investimeve të Infrastrukturës



Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit






Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse




Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
trajtimimit të AMTP



Drejtoria e Turizmit



Drejtoria e Ndhimes Ekonomike dhe Personave
me Aftesi Ndryshe



Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit
të Ujërave



Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,
Koordinimit të Investimeve

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit



Policia Bashkiake

